# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-469011**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | I kërkohet Avokatit të Popullit ta dërgojë Ligjin për Specialen në Kushtetuese |
| ADRESA | `https://albeu.com/kosove/i-kerkohet-avokatit-te-popullit-ta-dergoje-ligjin-per-specialen-ne-kushtetuese/1027253/` |
| BURIMI | albeu.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 25 shtator 2026, 13:30:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 13:29:07 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `0453b5efa03f4c2f33079d69355554c31bdb424417492e0461a303df9f846b19` |
| TEKSTI | `926f0b8005b602044f6e50c25c01480f71e549e85cf3135237a435f1aa57dbcc` |
| PAMJA | `162044d7742387b55119521e1d65cb405393ecc892b1755474d75bce33fda341` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dd0e464140c2f794d6e62719f7fb45ddaf0e2514840c1f309c9eccea0627fe5d` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3a6c0ee943067392b175e06ac07a7b9996bbd474953cea4f063ab0e5555023da` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dd0e464140c2f794d6e62719f7fb45ddaf0e2514840c1f309c9eccea0627fe5d`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# I kërkohet Avokatit të Popullit ta dërgojë Ligjin për Specialen në Kushtetuese




Përfaqësues të shoqërisë civile, të komunitetit akademik dhe të organizatave për të drejtat e njeriut i kanë kërkuar Avokatit të Popullit, Naim Qelaj, që ta procedojë në Gjykatën Kushtetuese Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

Sipas kërkesës, Kushtetuesja duhet të shqyrtojë nëse mandati i Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë është zgjeruar përtej autorizimit të parashikuar në nenin 162 të Kushtetutës së Kosovës.

Neni 162, paragrafi 1, i Kushtetutës, thuhet në kërkesë, mundëson krijimin e Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar në mënyrë që Republika e Kosovës të përmbushë detyrimet ndërkombëtare që lidhen me Raportin nr. 12462 të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, të datës 7 janar 2011, të hartuar nga raportuesi Dick Marty.

Ligji, nga ana tjetër, përcakton se institucionet janë ngritur për të trajtuar procedura mbi pretendime për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare, të ndërlidhura me pretendimet e raportit dhe të hetuara nga Task Forca Hetimore Speciale. Kjo, sipas nënshkruesve, tregon se Kushtetuta nuk ka autorizuar krijimin e një juridiksioni të përgjithshëm penal pa kufizime.

“Kushtetuta ka mundësuar një mekanizëm të specializuar brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës, të përcaktuar për një qëllim kushtetues të caktuar dhe të lidhur me pretendimet që çuan në krijimin e tij”, thuhet në kërkesë.

Nënshkruesit vlerësojnë se përmbledhja e aktgjykimit në çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit e ka nxjerrë më qartë në pah mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të këtyre dispozitave.

Sipas tyre, përmbledhja trajton gjerësisht historinë, organizimin, udhëheqjen dhe strukturat politike e ushtarake të UÇK-së, komunikatat publike, emërimet, shërbimet e inteligjencës, policinë ushtarake, zonat operative, si dhe

të fundit/

Gjimshiti: Synojmë kreun e grupit, ndaj Bjellorusisë duhet të…

Pse Uellsi e bën qëllimisht të çrregullt fotografinë e ekipit pa…

Mbërrin në Shqipëri ambasadori i ri i SHBA, Eric Wendt i dorëzon…

Ndihmësi i Artetës: Vinicius Junior ishte në listën e Arsenalit

Gërvalla: Projektligji për Byronë i është dërguar Zyrës së Kryeministrit

Melania Trump flet për raportin me Barronin: Ai ndonjëherë preferon …

Plagoset një person te “Zogu i Zi” në Tiranë, i lënduari dërgohet me…

Aleanca për Media Etike ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

synimet për pavarësinë e Kosovës dhe vendosjen e kontrollit politik e institucional.

“Trupi gjykues ka bërë të ditur se çështja nuk kishte të bënte me legjitimitetin e UÇK-së apo me synimin e saj për një Kosovë të pavarur. Ky sqarim ka rëndësi. Megjithatë, gjerësia e analizës shtron pyetjen nëse lidhja me pretendimet konkrete të Raportit të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës ka shërbyer si kufi i vërtetë dhe efektiv për juridiksionin, apo si bazë për ushtrimin e një juridiksioni shumë më të gjerë mbi organizimin dhe veprimtarinë e UÇK-së gjatë dhe pas luftës”, thuhet në kërkesë.

Kërkesa paralajmëron se, nëse formulimi “të cilat ndërlidhen me Raportin e Asamblesë së Këshillit të Evropës” kuptohet aq gjerësisht sa të përfshijë çdo krim të pretenduar, individ, strukturë, politikë ose zhvillim me lidhje të përgjithshme historike me UÇK-në, kufizimi i nenit 6 mund të humbasë fuqinë e tij juridike.

Nënshkruesit, emrat e të cilëve janë paraqitur sipas rendit alfabetik:

1. Prof. Dr. Enver Hasani, ish-kryetar i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

2. Abit Hoxha, profesor asistent në Institutin për Studime Nordike dhe të Medias, Universiteti i Agderit, Norvegji.

3. Agon Maliqi, aktivist i shoqërisë civile.

4. Dr. Armend Bekaj, hulumtues në Departamentin për Hulumtime të Paqes dhe Konfliktit, Universiteti i Uppsalës, Suedi.

5. Dr. Artan Mustafa, Universiteti i Prishtinës.

6. Bajram Geci, hulumtues doktorature.

7. Dr. Butrint Berisha, hulumtues.

8. Dr. Fisnik Korenica, profesor i asociuar i së drejtës në Universitetin e Prishtinës.

9. Fisnik Rexhepi, aktivist i shoqërisë civile.

10. Ideal Zhaveli, drejtor ekzekutiv i ACTIVISM ROOTS.

11. Ismet Kryeziu, drejtor ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI).

12. Jeta Loshaj, aktiviste e shoqërisë civile.

13. Laura Kryeziu, Këshilli për Lidership dhe Zhvillim (LGC).

14. Leonora Kryeziu, drejtore ekzekutive e Institutit të Prishtinës për Studime Politike (PIPS).

15. Dr. Liridon Lika, ligjërues dhe hulumtues në Qendrën për Studime të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Departamenti i Shkencave Politike, Universiteti i Liezhit, Belgjikë.

16. Dr. Lulzim Peci, drejtor ekzekutiv i Institutit Kosovar për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (KIPRED).

17. Naim Rashiti, drejtor i Grupit për Hulumtim të Politikave Ballkanike (BPRG).

18. Dr. Nevenka Tromp, ligjëruese e Studimeve Evropiane në Universitetin e Amsterdamit.

19. Dr. Ramadan Ilazi, udhëheqës i hulumtimeve në Qendrën Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS).

20. Dr. Robert Muharremi, profesor asistent në RIT Kosovo.

21. Senad Sabovic, aktivist i shoqërisë civile.

22. Shenoll Muharremi, aktivist i shoqërisë civile.

23. Shpëtim Selmani, poet.

24. Visar Ymeri, drejtor ekzekutiv i Institutit për Politika Sociale “Musine Kokalari”.

Shtuar më 25.09.2026 15:29

Tags: avokati , Ligji , populli , specialja











Gërvalla: Projektligji për Byronë i është dërguar Zyrës së Kryeministrit

Nagavci: Kanë mbetur 11 ditë për zgjedhjen e presidentit, nevojitet qasj…

Haxhiu: Familjarët e Thaçit, Veselit dhe Krasniqit nuk e pranuan ftesën për takim

Von der Leyen të enjten viziton Prishtinën






Kurti paralajmëron zgjedhje të reja në rast të moszgjedhjes së presidentit

Tahiri: Mungon vullneti politik për zgjedhjen e presidentit

Nga 25 në 31 vjet burg? Prokuroria kërkon edhe gjashtë vite për Hashim…

Kërkesa për gjashtë vite burg mund ta çojë dënimin e Thaçit në 31 vjet

albeu që nga viti 2003 © 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko… Kërko

**Kryesore**
- Erion Veliaj
- Free Esim
- Zgjedhjet 2025
- Belinda Balluku
- SPAK
- Kombëtarja

**Kategori**
- Lifestyle
- Showbiz
- Tech
- Shëndetësi
- Argetim
- Enciklopedi

**Linqet**
- Live tv shqiptare
- Moti në Shqipëri
- Travel
- Horoskopi
- Livescore
- News from Albania

**Tags**
- Edi Rama
- Albania News
- Ilir Meta
- Piranjat
- gazeta, tv, portale
- Sali Berisha

**Moti**
- Moti në Tiranë
- Moti në Prishtinë
- Moti në Shkup
- Moti në Durrës
- Moti në Prizren
- Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktoni | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.